



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-06/IA020

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 26 maj 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidencial

---

## Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

---

**Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:**

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Kai Ambos

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit:**

Gregori Kihou

**Mbrojtjes së Kadri Veselit:**

Ben Emerson

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit:**

Dejvid Jang

**Mbrojtësit të viktimave:**

Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:**

Venkatesvari Alagendra

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c), 41(10) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 58(1), (2), 169 dhe 170(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një Panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi “Apelin e Mbrojtjes së Krasniqit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit me Shtojcën 1, Publike” (“Apeli”).<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 13 maj 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi “Versionin e Redaktuar Konfidencial të Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit, ku, ndër të tjera, urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Jakup Krasniqi.”<sup>2</sup>
2. Më 25 maj 2022, z. Krasniqi dorëzoi Apelin.

## II. KLASIFIKIMI

3. Apeli është klasifikuar si konfidencial dhe për rrjedhojë dhe ky vendim do të ketë të njëjtin klasifikim në pajtim me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të riklasifikohet më vonë në pajtim me rregullën 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

## III. CAKTIMI

4. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe

---

<sup>1</sup> IA020/F00001, Apel i Mbrojtjes së Krasniqit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Jakup Krasniqit me Shtojcën 1, Publike, 25 maj 2022 (konfidencial).

<sup>2</sup> F00801/CONF/RED, Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit, 13 maj 2022 (konfidencial), para. 87.

disponueshmërisë në këtë moment,

**KRYETARJA ME KËTË VENDIM ÇAKTON:**

**Gjykatësen Mishelë Pikar**

**Gjykatësin Emilio Gati**

**Gjykatësin Kai Ambos**

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi Apelin.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,  
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E enjte, 26 maj 2022  
Në Hagë,  
Holandë